



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_728_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Neni 11 i licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e Procedurës për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare të datës 18 shkurt 2015,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **Aprovohet** dokumenti *Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare*

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18 shkurt 2015 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e Procedurës për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare.

Në vitin 2007 KOSTT ka zhvilluar dokumentin Procedurat Operacionale për alokimin e kapaciteteve transmetuese, të cilën ZRRE e ka aprovuar me datë 30.01.2007. Deri me tani implementimi i dokumentit ka qenë i pamundur për shkak se KOSTT nuk ka bërë alokimin e kapaciteteve interkonektive. Me krijimin e rrethanave të reja për KOSTT së shpejti do të filloi së funksionuari alokimi i kapaciteteve Interkonektive. Duke pasur parasysh se dokumenti në fuqi nuk i përmbushë në tërësi kërkesat, KOSTT ka zhvilluar versionin e ri të dokumentit, i cili bazuar në përvojat e fituara ndryshon shumë nga versioni paraprak.

ZRRE pas shqyrtimit, komentimit dhe vlerësimit të dokumentit, konsideron se dokumenti plotëson kriteret e nevojshme për të qenë si rregull bazë për kryerjen e aktivitetit të ankandit për alokimin e kapaciteteve dhe e ka parë të arsyeshme që të **Aprovohet** dokumenti **Procedura për Ankandet e Kapaciteteve Interkonektive dhe Nominimet e Kapaciteteve Ndër-Kufitare**.


Hyrja në fuqi e këtij dokumenti shfuqizon dokumentin Procedurat Operacionale për alokimin e kapaciteteve transmetuese të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 30.01.2007.





- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar